


25.08.2021



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRË NË DORËZIM		PRIMLJENO - RECEIVED	
Nësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Braj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	06	5503	2

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 34, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L040, dispozitave të statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë me datë 14.09.2021, lidhë këtë :

Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi
 në mes të
Shoqata Grejkoci”
 dhe
Komunës së Suharekës

Neni 1
Objekt i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Shoqatës Grejkoci” , të përfaqësuar nga **Regjep Neziraj , Kryetar i Shoqates**, dhe në mes të Komunës së Suharekës, të përfaqësuar nga **Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës**, me qëllim të financimit të projektit të ndërtimit të parkut të Gryka dhe rregullimi i liqenit artificial si dhe mbjellja e fidaneve në fshatin Grejkoc.

Neni 2
Kushtet për formimin e kësaj marrëveshje

Kjo marrëveshje parasheh ndërtimin e parkut të Gryka dhe rregullimi i liqenit artificial si dhe mbjellja e fidaneve në fshatin Grejkoc, Komuna Suharekë, i cili do të shërbejë për rekreacion për banoret e këtij Lokaliteti.

Neni 3
Qëllimi i marrëveshjes

- 3.1 Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira , dhe ambient sa më të pastër për banore e këtij lokaliteti dhe
- 3.2. Shoqata Grejkoci në mënyrë vullnetare, të pavarur dhe vullnetë plotë, obligohet dhe zotohet për implementimin dhe realizimin e këtij projekti.

Neni 4
Obligimet e Shoqatës

4.1 Shoqata Grejkoci është institucioni implementues i këtij projekti i cili parasheh periudhën e ndërtimit dhe implementimin e këtij projekti.

4.2 Shoqata Grejkoci merr persiper keto obligime sa i perket qellimit të këtij memorandumi , si ne vijim ;

Raportimi duhet të bëhet me shkrim para institucioneve të Komunës së Suharekës
4.3 Komuna do të caktoj një mbikqyrës I cili do të përcjell të gjitha punimet dhe do të bëjë raport me shkrim për ecurin e realizimit të këtij projekti.

Neni 5 Afati i Realizimit

Afati i realizimit të qëllimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda vitit 2022

Neni 6 Obligimet e Palëve

- 6.1** Vlera e gjithëmbarshme e projektit është 36,00.00€
- 6.2** Komuna e Suharekës, do të participoj shumën prej 12,000.00€
- 6.3** Shoqatës Grejkoci,do të participoj vlerën tjetër prej 24,000.00€
- 6.4** Komuna e Suharekës do të participoj shumën prej 12,000.00 Euro Këto mjete do të lëshohen në gjyrollogarinë bankare të Shoqatës Grejkoci, pas raportimit të organit mbikqyrës të përcaktuar nga Komuna e Suharekës.

Neni 7 Interpretimi dhe Ndryshimi

- 7.1** Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
- 7.2** Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga ana e dy palëve.

Neni 8 Zgjidhja e Marrëveshjes

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim.

Neni 9
Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuar me këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

PALËT NË MARRËVESHJE

Shoqata Grejkoci
Regjep NEZIRAJ



Kryetar i Shoqatë

Komuna e Suharekës
Bali MUHARREMAJ



Kryetar i Komunës

25 Gusht 2022
Komuna e Suharekës